



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS  
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS  
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

**Numri i lëndës:** KSC-BC-2018-01/IA001

**Vendosi:** Kryetarja e Dhomave të Specializuara  
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

**Administratore:** Fidelma Donlon

**Data:** 27 gusht 2021

**Gjuha:** Anglishte

**Klasifikimi:** Publik

---

## Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit

---

### Gjykatësve të Panelit të Gjykatës së Apelit:

Gjykatëse Mishelë Pikar

Gjykatës Emilio Gati

Gjykatës Kai Ambos

**Zyrës së Prokurorit të Specializuar:**

Xhek Smith

**Mbrojtësit të Specializuar**

Tobi Kadman

**KRYETARJA** e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke marrë parasysht nenet 33(1)(c) dhe 45(2) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar, rregullat 77(1), 169 dhe 170(2) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht “Rregullorja” dhe “DHSK”) dhe rregullat 3 dhe 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton një panel të Gjykatës së Apelit në vijim të vendimit të Gjykatësit të Vetëm me të cilin, ndër të tjera, i miratoi z. Driton Lajçi lejen për të apeluar pjesërisht vendimin (“Vendim për Miratimin e Lejes për Apelim”).<sup>1</sup>

## I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 23 korrik 2021, Gjykatësi i Vetëm rrëzoi kërkesën e z. Lajçi për urdhër drejtuar Zyrës së Prokurorit të Specializuar për pushimin e hetimit kundër z. Lajçi (“Vendimi i Kundërshtuar”).<sup>2</sup>
2. Më 29 korrik 2021, z. Lajçi kërkoi leje të apelonte Vendimin e Kundërshtuar (“Kërkesa”).<sup>3</sup>
3. Më 24 gusht 2021, Gjykatësi i Vetëm nxori Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim, në të cilin, ndër të tjera, miratoi Kërkesën, për pjesën që ka lidhje me interpretimin e tij të rregullës 47 të Rregullores.<sup>4</sup>

## II. CAKTIMI

---

<sup>1</sup>F00184, Vendim mbi Kërkesën për Leje për Apelim të Vendimit F00180, 24 gusht 2021.

<sup>2</sup> F00180/RED, Versioni i redaktuar publik i Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimit kundër Driton Lajçit, 23 korrik 2021.

<sup>3</sup> F00181, Kërkesë për Autorizim për Leje për Apelim të Vendimit mbi Kërkesën për Urdhër drejtuar Prokurorit të Specializuar për Pushimin e Hetimeve kundër Driton Lajçit, 29 korrik 2021.

<sup>4</sup> *Shih* Vendimin për Miratimin e Lejes për Apelim, para. 5(c), 32(b).

4. Pas shqyrtimit të kriterëve të parashikuara në rregullën 4 të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve, duke përfshirë përvojën dhe kompetencën përkatëse, si edhe disponueshmërinë në këtë moment,

**KRYETARJA ME KËTË VENDIM ÇAKTON:**

**Gjykatësen Mishelë Pikar**

**Gjykatësin Emilio Gati**

**Gjykatësin Kai Ambos**

në Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur në lidhje me Apelin.

/nënshkrimi/

---

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova**  
**Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E premte, 27 gusht 2021  
Hagë,  
Holandë